



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË
KRYETARI I KËSHILLIT**

Nr 2216 Prot

Gjirokastër më 03 : 03:2023

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 28.02. 2023.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 28.02. 2023

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në **datë 28.02.2023** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në sallën e hotel “Çajupit”. Mbledhja fillon në orën 12.09. Hapet mbledhja nga z. Hasani Marrin pjesë në mbledhje 19 anëtarë. Mungojnë në mbledhje Isaraj, Zhapa, Hilaj, Balloma, Guçe, Rami, Shehaj, Feruni, Xheko, Çamani, Veizaj, Në fillim të mbledhjes, Z. Hasani i fton pjesëmarrësit të mbajnë një minutë heshtje në kujtim të këshilltarit z. Asllan Karagjozi, i cili humbi jetën në fillim të muajit shkurt.

Z. Hasani paraqet para këshilltarëve rendin e ditës dhe materialet shtesë të cilat kanë ardhur pasi është shpërndarë rendi i ditës të cilat janë:

1.P/Vendim “ Për shpalljen e vitit 2023 si “Viti I Liceut”

2. P/Vendim “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë”

3. P/Vendim “Për miratimin e shtyrjes së afatit për subvencionin e interesit të kredisë, financuar nga fondet e buxhetit të bashkisë Gjirokastër për z. Misto Kano, për një periudhë 6 mujore”.

4.P/Vendim “Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave , të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit për z. Nuri Ahmeti”.

5.P/Vendim për “Miratimin e marrëveshjes së Këshillit të Qarkut me Këshillin Bashkiak Gjirokastër”.

Kërkohet nga Kryetari i Këshillit sqarim për pikat e ardhura nga Drejtoria e Shërbimit Social pranë bashkisë Gjirokastër .

Znj. Albana Allushi: Sqaron këshilltarët për materialet e ardhura . Në lidhje me P/Vendimin “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë” sqaroj se në mbledhjen e kaluar ju miratuat 33 individë/familje përfituese të cilat janë përfituese, por nga komunikimi me Ministrinë e Financave duhet që vlera e qirasë të miratohet çdo vit dhe përkatësisht : 8.000 lekë për familjet me 1, 2 persona, 13.000 lekë për 3 persona , 16.500 për 4 persona dhe 22.000 mbi 4 persona.

Kurse dy rastet e tjera janë rutinë, rasti i z. Kane ka të bëjë me shtyrjen e afatit për një periudhë 6 mujore dhe privatizimi i banesave të cilat vijnë rast pas rasti.

Sqaron për marrëveshjen me Këshillin e Qarkut znj. Rova. Kjo marrëveshje ka të bëjë me vendosjen e një fondi prej 60 milion lekë të vjetra që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e dy rrugëve ku bashkia vendos fuqinë punëtore dhe Këshilli i Qarku materialet që duhen.

Hidhet në votë dhe miratohet rendi i ditës me pikat shtese me 19 vota pro.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjeve të datës 31.01.2023.
2. P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-28.02. 2023**".
3. P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-28. 02.2023**".
4. P/Vendim "Për miratimin e të ardhurave afatmesme 2024-2026 në bashkinë Gjirokastrë".
5. P/Vendim "Për një shtesë në Vendimin nr. 100, datë 16.12.2022 "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023 nga shpërndarja e të trashëguarës 2022".
6. P/Vendim "Për miratimin e listës dhe vlerave financiare të individëve/familjeve për mbështetje me subvencion kredie nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe fondet e Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2023"
7. P/Vendim "Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së përgjithshme të transportit rrugor dhe bashkisë Gjirokastrë".

Raport i vjetor i punës së Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare dhe 5 pikat që u cituan më lart.

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.01.2023.

Hidhet në votë dhe miratohen me 19 vota pro dy pikat e rendit të ditës.

Z. Hasani: Kalojmë te pikat 4 dhe 5 të rendit të ditës. Këto dy pika janë kaluar në Komisionin e Ekonomisë .

Znj. Rova: Komisioni i ka kaluar materialet por mendoj të dëgjojmë ekzekutivin sepse nuk dua të biem në përsëritje. Përsa i përket raportit të të ardhurave afatmesme 2024-2026 janë parashikime të mira që shpresojmë të realizohen.

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro:

P/Vendim "Për miratimin e të ardhurave afatmesme 2024-2026 në bashkinë Gjirokastrë"

Kalohet te pika 5. Sqaron për këshilltarët z. Flamur Golemi.

Shpërndarja e të trashëguarës është e rëndësishme për mbështetjen e zonave rurale . Mbase kemi pasur pak vonesa, por është punuar fshat më fshat dhe në të gjithë territorin për të nxjerrë nevojat reale për ndërhyrje dhe janë planifikuar 50 milion lekë në Njësitë Administrative dhe me një vlerë totale të të trashëguarës deri në 265 milion lekë e ndarë në 5 milionë për ndihmë ekonomike , 20 milion për Festivalin Folklorik, 20 milion për terminalin për shpronësimet. Siç e shikoni pjesën më të madhe të ndërhyrjes do ta kene rrugët në njësitë administrative ku pjesën më të madhe do ta kenë njësitë administrative, konkretisht në rrugët e fshatrave Prongji, Gjat, Tërbuq, Mingul, Valare, Dhoksat, Hundëkuq etj.

Gjithashtu mbase kemi qenë të vonuar me këto ndërhyrje, por do të vazhdojmë edhe me tej me ndërhyrjen dhe mbështetjen e Fondit Shqiptar të Zhvillimit.



Pyetje: Z. Hasani: Çfarë është bërë me rrugën e brendshme në fshatin Asim Zeneli? Kemi qenë dhe në dëgjuesë publike ku është kërkuar ndërhyrja.

Z. Golemi: Jemi fokusuar te akset kryesore, akset në rrugën hyrëse dhe hap pas hapi do futemi edhe në rrugët lidhëse midis lagjeve. Me projektin e 100 fshatrave do të vazhdojë puna me ndërhyrje në qendrat e fshatrave Zhulat, Dhoksat dhe Lazarat. Shpresoj të ecim shpejt dhe të zbatojmë projektet e fituara.

Miratohet me 19 vota pro P/V P/Vendim "Për një shtesë në Vendimin nr. 100, datë 16.12.2022 "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023 nga shpërndarja e të trashëguarës 2022".

Kalohet te pika 6 e rendit të ditës.

Shprehet për komisionin e Shërbimit Social, Strehimit dhe mbrojtjes Sociale znj Eduina Guga.

Komisioni është mbledhur dhe e ka shqyrtuar me detaje materialin dhe është shprehur për kalimin e materialit në mbledhjen e sotme.

Z. Brahimi: Komisioni e ka parë materialin dhe lista është gjithëpërfshirëse, ka një shpërndarje në gjithë territorin e bashkisë Gjirokastrë, janë njerëz që kanë nevojë për mbështetje dhe vërej që nuk janë parë politikisht, por nga ana sociale. Falënderoj bashkinë dhe drejtorinë përkatëse për punën e bërë me përgjegjësi.

Z. Hasani; Bashkia dhe Këshilli punojnë për gjithë qytetarët.

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro P/Vendim "Për miratimin e listës dhe vlerave financiare të individëve/familjeve për mbështetje me subvencion kredie nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe fondet e Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2023".

Kalohet te pika 7 e rendit të ditës: Materiali ka kaluar në Komisionin Juridik.

Sqaron Z. Golemi për qëllimin e kësaj marrëveshje e cila ka të bëjë me ndërtimin e terminalit ku bashkia merr përsipër truallin së bashku me shpronësimet e nevojshme dhe DPTRR merr përsipër ndërtimin e terminalit. Kjo është faza e parë që i hap rrugën bashkisë për hapin e parë dhe do vazhdojë me tëj me paraqitjen e projektit dhe specifikimet e vlerave që i takojnë dhe mënyrën e funksionimit të cilat do të jenë përsëri para jush për miratim. Ky është një investim publik i cili në fund i mbetet prapë bashkisë, pas plotësimit të kontratës me investitorin. Vendi është i përcaktuar dhe i miratuar në Këshill me Planin e Përgjithshëm Vendor në vitin 2015. Sipërfaqja varet nga projekti dhe do të vijë në Këshill për shpronësim. Gjithashtu ndërtimi i terminalit sjell edhe zhvillim të zonës në lagjen "Zinxhira", si dhe rritje të vlerës së pronës për banorët që kanë objektet e tyre në këtë zonë.

Z. Hasani hedh në votë P/Vendim "Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor dhe Bashkisë Gjirokastrë" dhe miratohet me 19 vota pro.

Z. Hasani: Kalojmë te pikat shtesë;

1. Viti i Liceut ku ne e kemi të planifikuar edhe te PBA dhe buxheti vjetor 2023 dhe padyshim që grupi i punës ka bërë një plan për këtë.

Z. Naçi: Falënderoj bashkinë për këtë nismë që ka marrë në lidhje me "Vitin e Liceut", propozoj që të bëhen edhe fletëpalosje dhe të njihen edhe nxënësit e shkollave 9-vjeçare me historikun e gjimnazit. Mirë do të ishte që të kishte në mbledhje edhe përfaqësues të gjimnazit.



Z. Brahimi: Si ish nxënës të këtij gjimnazi kemi qenë pjesëmarrës në 50 vjetorin e gjimnazit dhe sot ndihemi të vlerësuar për këtë vendim që ka të bëjë me aktivitetet e planifikuara për 100-vjetorin e gjimnazit.

Z. Golemi : Marr shkas edhe nga situatë në gjimnazin “ Siri Shaplllo” , ku ka problem me lagështinë në 2-3 klasa të katit të tretë. Kemi të bëjmë me një investim të vitit 2015 dhe problem është shfaqur që vitine parë, kemi bërë një ndërhyrje në dhjetor me një fond të miratuar nga ju për ndërhyrje të pjesshme, por duke parë situatën jemi duke planifikuar që me rialokimin e fondeve në qershor të bëjmë një ndërhyrje të plotë në taracën e shkollës. Ju jeni në dijeni të investimeve në institucionet arsimore dhe vëmendjen që kanë marrë këto investime dhe le ta kemi këtë vit edhe në kuadër të 100 vjetorit të gjimnazit si vitin e arsimit në të gjitha shkollat e bashkisë Gjirokastrë.

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro:

P/Vendim “Për shpalljen e vitit 2023 si “Viti I Liceut”.

Z. Hasani propozoj që 4 pikat shtesë meqë u diskutuan që në fillim të mbledhjes dhe kanë të bëjnë me çështje sociale të kalohen në bllok.

Hidhen në votë dhe miratohen me 19 vota pro:

P/Vendim “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë”

3. P/Vendim “Për miratimin e shtyrjes së afatit për subvencionin e interesit të kredisë, financuar nga fondet e buxhetit të bashkisë Gjirokastrë për z. Misto Kano, për një periudhë 6 mujore”.

4. P/Vendim “Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave , të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit për z. Nuri Ahmeti”.

5. P/Vendim për “ Miratimin e marrëveshjes së Këshillit të Qarkut me Këshillin Bashkiak Gjirokastrë”.

Kalohet te pika e fundit; Analiza e punës së Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare pranë bashkisë Gjirokastrë.

Z. Astrit Kore bën një përmbledhje të punëve të kryera dhe problematikave të shfaqura sidomos gjatë periudhës së dimrit.

Nga këshilltarët u shtruan problem të hasura në zonat e tyre dhe u lanë afate për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Mbyllet mbledhja nga z. Hasani në orën 13:10.

Sekretar

Etleva Yzo

